

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
2E & Co

Sot me daten 07.12.2023

•**Zj. Esma Sharka** shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje, e banues ne Tiranë, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 036870902 dhe me nr personal J15825104A qe deklaron se ka vendosur te themelojë krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar 2E & Co Group (me poshte referuar si Shoqeria).

Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti dhe legjislativi shqiptar per shoqerite tregtare.

Neni 1 - Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte **2E & Co**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqerise eshte ne Rruga "Sabri Preveza", Pallati "GORA", kati 0, Yzberish, 1061, Tirane.

Neni 3 - Kohezgjatja do te jete e pakufizuar.

Neni 4 - Objekti i shoqerise

4.1 Shoqeria ka si objekt;

Shoqeria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Në fushën e IT-së:

Projektim, programim, informatizim, digitalizim, krijim, zhvillim, implementim, hostim, pershtatje dhe lokalizim, konfigurim, integrim, mirembajtje dhe trajnim per sisteme software te gjitha llojeve, programe dhe aplikacione, dhe sisteme software onpremise, web-based, cloud dhe hybrid. Sherbim



konsulence ne fushen e teknologjise se informacionit per dizenjimin dhe implemetimin e sistemeve hardware dhe/ose

software per cdo subjekt privat dhe shteteror. Kryerja e sherbimeve dhe tregtise se pajisjeve e materialeve elektronike ne fushen e IT-se. Kryerja e te gjitha llojeve te marketingut digital, ndermjetesimit dhe konsulences online brenda dhe jashte vendit. Krijim, menaxhim website, fushata marketingu ne internet. Servera ne Cloud. Mbrojtja dhe siguria ne internet. Antiviruse dhe software te tjere per mbrojtjen e sistemeve informatike. Ndertim, zhvillim dhe operim i qendrave te te dhenave, dhe te infrastruktureve perkatese software dhe hardware. Zhvillim, operim dhe konfigurime te sistemeve te sigurise kibernetike (cyber security, etj) dhe fizike, perfshire sisteme CCTV, akses control, sisteme alarmi, kundra zjarri etj. Shitje dhe qiradhenie e sherbimeve apo pajisjeve te mesiperme. Mirembajtje e sistemeve apo pajisjeve te mesiperme. Import, eksport, tregtim, shit-blerje me pakice dhe shumice te cdo lloj produkti, perpunim, konfigurim, dhe krijim implementim, mirembajtje e sistemeve software dhe hardware, pajisje kompjuterike, IT, zyrash, kancelarike, pajisjeve elektronike, elektrike, informatike, Sherbime transmetimi te dhenash, informacionesh, interneti, rrjetesh.

Konsulence, tajnim, projektim, zbatim ne fushen e Shendetesise, Ndertimit, Energjise, IT-se, Turizmit dhe Mjedisit.

Projektim dhe zbatim: Linja e rrjeta elektrike, telefonike, radiotelefonike, citofoni, sisteme alarmi, kamera vezhgimi, zjarri, sizmik, televizive, e tjera , per objekte civile , industriale, turistike. Impianti te sinjalistikes ndricuese te trafikut. Monitorim, auditim per sigurine dhe shendetin ne pune, kualifikim, instruktim, certifikim te personelit elektrik dhe aktiviteteteve qe kryejne ndertime linjash, nenstacione elektrike dhe instalime elektrike ne objektet e banimit, industrial, etj. Import, eksport te çdo lloj paisjeve elektrike, invertera, panele fotovoltaiche , kabllo elektrike te tensionit te ulet, mesem, e te larte , transformatore etj. Tregtimi me shumice e pakice te tyre. Sherbime konsulente Konsulent per sistemet e ndricimit te objekteve civile, industriale, turistike, rruge dhe vepra arti, etj. Konsulence per ndertimin e centraleve fotovoltaiche, hidrocentraleve, impianteve te prodhimit te energjise me ere. Konsulence per ndertimin e nenstacioneve elektrike sistemet e matjes, mbrojtjes rele, monitorimit dhe mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike. Pergatitja dhe shperndarja e dietave te personalizuara.

Në fushën e shendetesise:

Implementim dhe mirembajtje e sistemeve kompjuterike per menaxhimin spitalor te gjithe struktura spitalore dhe medikamenteve. Import eksport, tregtim i barnave dhe pajisjeve mjekesore, implante, pajisje Laboratorike dhe Diagnostike, pajisje kirurgjike dhe instrumenta kirurgjikale, Produkte Parafarmaceutike dhe Farmaceutike, kite, reagente.

Menaxhimi i sistemeve te informacionit shendetesor dhe jo vetem. Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve njerezore ne sektorin e kujdesit shendetesor dhe jo vetem. Analiza e riskut ne sektorin e kujdesit shendetesor dhe jo vetem. Integrimi social Mbrojtja dhe zhvillimi social dhe mjedisor. Rehabilitimi dhe dizenjimi spitalor. Planifikimi i njesive te kujdesit shendetesor dhe jo vetem. Mbikqyrja e kontruksioneve spitalore dhe njesive te kujdesit shendetesor. Pergatitja e tenderave per pajisje dhe punime ne njesite e kujdesit shendetesor dhe social dhe jo vetem. Studime fizibiliteti ne Sektorin

Shendetesor. Social dhe jo vetem. Pjesmarrje ne projekte kombetare dhe nderkombetare te cilat lidhen me zhvillimin e infrastruktures spitalore, zhvillimin e menaxhimit shendetesor, mbrojtjen sociale dhe jo vetem. Mbeshtetja per menaxhimin e cilesise' ne njesite e kujdesit shendetesor. Rishikim dhe rikonceptim i veprimeve ne sektor. Zbatimi i Sistemit te Raportimit te Menaxhimit te Cilesise dhe pajtueshmerise se Korporatave. Perzgjedhja e sistemeve IT dhe implementimi. Sherbime te ndermjetesimit te punesimit te profesionisteve te kujdesit shendetesor dhe jo vetem brenda dhe jashte Shqiperise. •Sherbime konsulencë kryesisht ne fushen e menaxhimit shendetesor por jo vetem, ne favor te subjekteve kombetare dhe nderkombetare, bazuar ne porosite e tyre dhe kontratat e nenshkuara. •Ofrimin e Aktiviteve te Edukimit ne Vazhdim per profesionistet e shendetesise. •Menaxhimi, administrimi i strukturave te hotelerise, rezidencave te banimit, sociale dhe sherbimeve mbeshtetese te tyre.

Në fushën financiare:

Kryerja e sherbimeve te ndermjetesimit ne biznes, marreveshjeve tregtare, dhe pasurive te paluajtshme. Kryerja e sherbimeve te kontabilitetit, kontroll te kontabilitetit dhe aktivitete te keshillimit fiskal. Kerkime tregu dhe aktivitete sondazhi. Keshillime biznesi dhe administrimi, brenda kufizimeve dhe ne perputhje me ndalesat e detyrueshme te ligjit te zbatueshem ne Shqiperi. Marketing & Shitje. Dhenie e rekomandimeve mbi permiresimin e biznesit, sistemeve kontabel dhe kontrollit te brendshem. Certifikim standartesh nderkombetare, certifikim punonjesish. Trajnime, kurse formimi profesional

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqind mijë) lek
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote, te gjitha te nenshkuara me vlore nominale 100.000 (njeqind mijë) lek

Neni 6 - Kontributet

- 6.1 Kontributi ne kapitalin e shoqerise ofruar si me poshte:

•**Zj. EsmaSharka** shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje, e banues ne Tiranë, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 036870902 dhe me nr personal J15825104A, do te ofroje nje kontribut ne para te barabarte me 100% te kapitalit fillestar prej 100 (njëqind) leke duke depozituar nje vlore te njezte ne llogarine e shoqerise pas formimit te saj;

Neni 7 - Transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.



Neni 8 - Administratoret

8.1 Me kete akt emerohet Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

Zj. Esma Sharka, atësia Yzeir, shtetase shqiptare, me vendlindje në Lushnje dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me letërnjoftimin ID me nr. 036870902 dhe me nr. personal J15825104A.

8.2 Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr.9901, date 14 prill 2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe nenit 14 te Statutit.

8.3 Administratori eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si edhe ka te drejte t'i delegoje kompetencat e tij personave te tjere.


Ky akt themelimi duke u gjetur konform kerkimit dhe vullnetit te plote e te lire të themeluesit, u pranua dhe u nenshkrua si me poshte:

O R T A K U I V E TË M

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

2E & Co

Esma Sharka

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Esma Sharka" followed by a stylized surname.